



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 506/5 Prot.

Tiranë, më 16 . 09 . 2015

V E N D I M

Nr. 98 , datë 16 . 09 . 2015

**“Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
nisur me urdhrin e verifikimit nr. 506/1, datë 16.07.2015”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr.437 datë 15.06.2006 të Komisionit të Shërbimit Civil, përsa i përket pagesës së pagave të prapambetura deri në momentin e rikthimit në punë, të punonjësit ***** .

VËREJ SE:

Në zbatim të urdhrit të verifikimit nr. 506/1 prot., datë 16.07.2015, është nisur verifikimi i informacionit, në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr.437 datë 15.06.2006 të Komisionit të Shërbimit Civil, përsa i përket pagesës së pagave të prapambetura deri në momentin e rikthimit në punë, të punonjësit ***** .

Nga shqyrtimi dokumentave të paraqitura nga Punonjësi ***** si edhe nga aktet e dërguara me shkresën nr. 181861/1prot, datë 27.07.2015, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, rezulton se ***** , me kërkesën e tij drejtuar K.Sh.C-së ka kërkuar shfuqizimin e Urdhërit Nr.2877, datë 07.03.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave. Me Vendimin Nr.437, datë 15.06.2006, të Komisionit të Shërbimit Civil, është shfuqizuar Urdhëri Nr.2877, datë 07.03.2006 i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, me anë të të cilit ***** është liruar nga detyra. Ky vendim i Komisionit të Shërbimit Civil është lënë në fuqi

dhe me Vendimin Nr. 184, datë 03.11.2006, të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe me vendimin nr. 00-2007-849, datë 22.06.2007, të Gjykatës së Lartë është vendosur mospranimi i Rekursit të ushtruar nga D.P.D-ja. Në bazë të kërkesës për lëshimin e Urdhërit të ekzekutimit drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë, kjo e fundit, me Vendimin Nr.46 datë 06.05.2009 ka vendosur, lëshimin e urdhrit të ekzekutimit ndaj Vendimit Nr.184 datë 03.11.2006, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Me aktin nr.149 prot datë 05.01.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, ***** është rikthyer në detyrë.

Nisur nga sa më sipër, konstatohet se procedura e ndjekur nga D.P.Doganave është e rregullt, përsa i përket rikthimit në punën e mëparëshme të Nëpunësit ***** , në zbatim të Vendimin Nr.437, datë 15.06.2006, të Komisionit të Shërbimit Civil i cili ka shfuqizuar Urdhërin Nr.2877, datë 07.03.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, për lirimin nga detyra.

Përsa i përket kërkesës së nëpunësit ***** , dhe pretendimit që ti paguhen prej D.P.Doganave të gjitha pagat e prapambetura, vlerësoj se :

Në zbatim të vendimit Nr.437, datë 15.06.2006, të Komisionit të Shërbimit Civil, lënë në fuqi me Vendimin Nr. 184, datë 03.11.2006, nga Gjykata e Apelit Tiranë, ***** i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me kërkesë për lëshimin e Urdhërit të ekzekutimit, dhe kjo e fundit, me Vendimin Nr.46 datë 06.05.2009 ka vendosur, lëshimin e Urdhërit të ekzekutimit ndaj Vendimit Nr.184 datë 03.11.2006, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Nga ajo çfarë evidentohet në vendimin e K.Sh.Civil, si edhe në vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tirane, rezulton se këto të fundit, janë shprehur vetëm mbi shfuqizimin e aktit administrativ, pa shprehur në vijim rregullimin e pasojave, duke mos i dhënë zgjidhje këtyre të fundit. Nga të gjitha aktet e vëna në dispozicion, nuk rezulton që ***** të jetë ankuar sipas ligjit, për të fituar edhe të drejtën e dëmshpërblimit, si rrjedhojë e shfuqizimit të Urdhërit Nr.2877, datë 07.03.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

Në vështrim të nenit 510 të K.Pr.Civile, K.SH.Civil dhe Gjykata e Apelit Tiranë kanë shfuqizuar aktin administrativ pa u shprehur mbi detyrimet e mëtejshme të Administratës Doganore. Ndodhur në këto kushte, D.P.Doganave nuk ka çfarë të ekzekutojë si detyrim, përveç rikthimit në punë të nëpunësit, pasi gjatë zhvillimit të këtyre proceseve administrativo gjyqësore, si K.SH.Civil ashtu edhe pala paditese, nuk kanë kërkuar apo vendosur, rregullimin e pasojave që rrjedhin nga shfuqizimi i Urdhërit Nr.2877, datë 07.03.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

Bazuar në sa më sipër, në analizë të dokumenteve shkresore të administruara, rrethanave të evidentuara dhe legjislacionit në fuqi, pretendimi i nëpunësit ***** , që përveç rikthimit në punën e mëparëshme, ti paguhen prej D.P.Doganave, të gjitha pagat e prapambetura për kohën që nuk është zbatuar vendimi nr.437 i K.SH.Civil, në vështrim të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, është i pa bazuar.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenin 16 dhe 34 të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit",

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të nisur në bazë të urdhrit të verifikimit nr. 506/1 prot., datë 16.07.2015, "Për zbatimin e Vendimit Nr.437 datë 15.06.2006 të Komisionit të Shërbimit Civil, përsa i përket pagesës së pagave të prapambetura deri në momentin e rikthimit në punë, të punonjësit *****".
2. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si edhe punonjësi ***** .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA